

BULETINI ELEKTRONIK

E-MAPAS NR. 45

MARS VITI 2023



MAPAS

AGJENCIA PËR MBIKËQYRJE TË FINANCMIT
KAPITAL TË SIGURIMIT PENSIONAL

SKEMA PENSIONIALE PROFESIONALE
SIPAS TË DREJTËS EVROPIANE

„Skema pensionale profesionale“ është skemë e dakorduar ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarve të tij ose shoqatës së qytetarëve dhe anëtarëve të saj, të përfshirë në fondin pensional vullnetar.

Rregullat lidhur me Skemën pensionale profesionale, në Sistemin pensional maqedonas, janë harmonizuar me Direktivën 2016/2341 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për aktivitetet dhe mbikëqyrjen e subjekteve për pensione profesionale (Directive 2016/2341 of the European Parliament and of the Council on the activities and supervision of institutions for occupational retirement provision).



Me Direktivën kërkohet rregullim i të gjitha çështjeve lidhur me funksionimin e skemës pensionale profesionale dhe atë: subjekte institucionale lidhur me skemën që në sistemin tonë janë shoqëri pensionale, fondi pensional dhe ruajtësi i pronës, mbikëqyrja e subjekteve – MAPAS, mënyra e anëtarësimit, mbrojtja e të drejtave dhe informimi i anëtarëve, rregullat për investim të mjeteve të paguara për skemën, aktivitetet tejkufitare ndërmjet vendeve anëtare dhe çështjet tjera. Të gjitha këto çështje janë rregulluar me Ligjin për sigurim pensional vullnetar me financim kapital.

Pas hyrjes së Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian siguruesi me seli në territorin e vendit tjetër anëtar të Bashkimit Evropian do të mund të organizojë skemë pensionale profesionale e cila do të përfshihet në fondin pensional vullnetar me të cilin menaxhon shoqëria me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Gjithashtu, shoqëria pensionale do të mund ta përfshijë në fondin pensional vullnetar skemën pensionale profesionale të siguruesit nga vend tjetër anëtar i Bashkimit Evropian pas marrjes së informacionit nga Agjencia të pranuar nga organet kompetente të vendit anëtar në të cilin gjendet selia e siguruesit potencial se janë përmbushur kushtet nga ligjet relevante për skemën pensionale profesionale në vendin anëtar.

Çelësi për pension është të kënaqeni në gjërat e vogla.

- Suzan Miler.

Që të kënaqeni në pensionimin e gjatë dhe të rrehatshëm, kurseni më shumë

- Anonim

Sipas rregullave ekzistuese në vendin tonë punëdhënësi ose shoqata e qytetarëve mund të organizojë edhe skemë pensionale profesionale financiare vetëm për të punësuarit ose anëtarët e tyre. Gjithashtu, shumë punëdhënës ose shumë shoqata të qytetarëve mund të organizojnë dhe financojnë së bashku skema pensionale profesionale. Punëdhënës ose shoqatë e qytetarëve me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut që organizon dhe financojnë skemë pensionale profesionale dhe paguan kontribute në fondin pensional vullnetar për të punësuarit ose anëtarët e tij është siguruesi. Siguruesi nënshkruan marrëveshje me shoqërinë të cilën e ka zgjedhur të menaxhojë me fondin pensional vullnetar në të cilin do të përfshihet skema pensionale profesionale.

Pas hyrjes në Bashkimin Evropian siguruesi me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut do të mund t'ia besojë menaxhimin me skemat e tij pensionale profesionale shoqërisë të autorizuar për të menaxhuar me skema pensionale profesionale në vend tjetër të Bashkimit Evropian, në pajtim me rregullat në Republikën e Maqedonisë së Veriut të harmonizuara me të Drejtën Evropiane.



Një sigurues mund të organizojë vetëm një skemë pensionale profesionale. Çdo sigurues ka rregulla për skemën pensionale profesionale dhe mund të caktojë se cilat të punësuar ose anëtarë mund të marrin pjesë në skemën pensionale profesionale duke e caktuar shkallën e kontributit të cilin do ta paguaje për secilin prej tyre. Secili person në afat prej 15 ditësh nga hyrja në marrëdhënie pune të punëdhënësi i cili ka organizuar skemë pensionale profesionale, ka të drejtën e kopjes së rregullave të skemës pensionale profesionale, statutit të fondit pensional në të cilin është përfshirë skema, pa dallim nëse në momentin e punësimit ka të drejtën e anëtarësimit në skemën pensionale profesionale.



Të punësuarit/anëtarët të një sigurues që janë përfshirë në skemën pensionale bëhen anëtarë të punësuarit/anëtarët të një sigurues që janë përfshirë në skemën pensionale bëhen anëtarë të fondit pensional vullnetar në të cilin është përfshirë skema. Anëtari në fondin pensional vullnetar në bazë të skemës pensionale profesionale i ka të drejtat e njëjta si anëtari në bazë të marrëveshjes për anëtarësim të lidhur me shoqërinë, përveç të drejtës për të paguar kontribut.

Pjesëmarrja në skemën pensionale profesionale ndërpritet me:

- ndërprerjen e marrëdhënies së punës ose anëtarësisë në shoqatën e qytetarëve dhe transferimin e mjeteve nga llogaria tjetër profesionale ose llogaria individuale vullnetare, në pajtim me ligjin;
- anulimin e skemës pensionale profesionale dhe transferimin e mjeteve nga llogaria profesionale ekzistuese në llogari tjetër profesionale ose llogari individuale vullnetare në pajtim me ligjin.

RISI

JAVA GLOBALE E PARAVE 20-26.03.2023

Rregullatorët financiarë në bashkëpunim me asociacionet dhe institucionet nga sektori privat dhe civil të cilët janë aktivë në domenin e edukimit financiar, viti i njëmbëdhjetë me radhë e shënuan Javën globale të parave që këtë vit u mbajt nga 20 deri 26 mars 2023.

Aktivitetet gjatë Javës globale të parave këtë vit kryesisht u zhvilluan përmes e-ligjërimit, ligjërimit me prezencë fizike dhe publikimeve të materialeve edukative në faqet e internetit të institucioneve dhe rrjeteve sociale. Ligjërimet u dedikuan për nxënësit nga shkollat fillore dhe të mesme nga vendi ynë, si dhe fakultetet, në tema nga sferat që i mbulojnë institucionet e caktuara, lidhur me funksionimin e sistemit financiar.



Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit PENSIONAL – MAPAS, vazhdoi me aktivitetet e saj edukative për të rinjtë dhe gjatë Javës globale të parave 2023. Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe organizatën joqeveritare Rrjeti interaktiv për arsim dhe resurs – RrIAR u vendos koordinim me një pjesë të fakulteteve shtetërore dhe private, ku së bashku me shoqëritë pensionale KB Shoqëria e parë pensionale SHA Shkup, Shoqëria pensionale Sava sh.a. Shkup dhe SHOQËRIA PENSIONALE TRIGLAV SHA Shkup, SHOQËRIA PENSIONALE VFP SHA SHKUP u mbajtën ligjërimi edukative të studentëve për rritje të vetëdijes të të rinjve për nevojën për edukim më të madh financiar me

qëllim shpenzimin e përgjegjshëm të financave personale menaxhimin e duhur me buxhetin vetjak dhe kursimin dhe investimin afatgjat shikuar në prizmin e përfitimeve dhe mundësi të cilat i ofron sistemi pensional në pjesën e sigurimit pensional me financim kapital.



Fillimi i Javës globale të parave 2023 filloi me edukimin dhe debatin e hapur publik me studentët e Fakultetit Ekonomik, Shkup të Universitetit Shën Cirili dhe Metodi. Në nivel botëror, Java globale e parave shënohet nga viti 2012, me ndërprerje të vetme në vitin 2020 për shkak të pandemisë, në organizim të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD). Kjo iniciativë globale, e cila deri tani shënohet në më shumë se 176 vende në botë, ku janë përfshirë 53 milionë fëmijë dhe të rinj, e rrit vetëdijen te të rinjtë për edukimin financiar dhe i rrit njohurit e tyre për paratë, kursimin, punësimin dhe sipërmarrësinë. Çdo vit, të rinjtë bisedojnë, lexojnë dhe mësojnë për sistemet ekonomike dhe për sistemet financiare përmes aktiviteteve më të ndryshme që i zbatojnë institucionet financiare dhe arsimore.

Më shumë informata rreth Javës globale të parave në lidhjen: www.globalmoneyweek.org



SHËNIMI I 21 MARSIT, DITA E PRANVERËS DHE EKOLOGJISË

Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional – MAPAS edhe këtë vit vazhdoi aktivisht me zbatimin e Planit për aktivitete në pjesën e avancimit të përgjegjësisë shoqërore dhe me atë rast u përfshi në shënimin e Ditës së pranverës dhe ekologjisë. Për atë qëllim, të gjithë të punësuarit të MAPAS realizuan aksion për mbjellje të drurëve në lokalitetin Milladinovcë.



MIRATIMI I RAPORTIT VJETOR TË KOMITETIT PËR STABILITET FINANCIAR: EDHE KRAHAS SFIDAVE, STABILITETIT ËSHTË RUAJTUR

Komiteti për Stabilitet Financiar, në mbledhjen e mbajtur më 6 mars 2023, e miratoi Raportin vjetor për punën e Komitetit për vitin 2022. Në Raportin vjetor ceket se sistemi financiar në vend është stabil, edhe krahas tensioneve të mëtutjeshme gjeopolitike nga invazioni ushtarak i Rusisë ndaj Ukrainës, si dhe sfidave globale lidhur me krizën energjetike dhe shkallët e larta të inflacionit. Megjithatë, në kushte të pasigurisë së rritur, ende më tepër është theksuar nevoja për vlerësim themelor të rreziqeve, menaxhim adekuat me rreziqet dhe ndërtimin e mëtutjeshëm të kapitalit për shkak të sigurimit të kapacitetit më të madh të institucioneve financiare për absorbim të rreziqeve.

Me hyrje në fuqi të Ligjit për stabilitet financiar u vendos korniza ligjore për zbatimin e politikës makroprudente në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Komiteti për Stabilitet Financiar, përcaktohet si trup ndërinstitutional përgjegjës për monitorimin e zbatimit të politikës makroprudente në vend dhe për koordinim të aktiviteteve gjatë përcaktimit dhe monitorimit të rreziqeve në segmente të caktuara nga Sistemi financiar,



gjatë ndërmarrjes së masave makroprudente dhe gjatë përgatitjes dhe menaxhimit me krizën financiare. Me Ligjin për stabilitet financiar u ndahen kompetenca eksplicite rregullatorëve të sistemit financiar për ndërmarrje të masave makroprudente të orientuara në zvogëlimin e vulnerabilitetit dhe rritjen e rezistencës së segmenteve të caktuara të sistemit financiar për të cilin ato janë kompetentë. Në atë mënyrë, rregullatorët kompetentë, në mënyrë individuale dhe së bashku përmes punës së Komitetit për Stabilitet Financiar, kontribuojnë në arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit financiar.

Komiteti është përbërë nga të gjitha rregullatorët e sistemit financiar në vend, përkatësisht Banka Popullore, Ministria e Financave, Komisioni për Letra me Vlerë, Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional dhe Agjencia për Mbikëqyrje të Sigurimit. Me Komitetin kryeson guvernatori i Bankës Popullore, e në kushte të krizës financiare mund të kryesojë edhe ministri i Financave, nëse ashtu vendosin guvernatori dhe ministri. Struktura e tillë mundëson zbatim konsekuent të rekomandimeve të Këshillit të Evropës për sigurim të mekanizmit efikas të bashkëpunimit ndërmjet të gjitha institucioneve me kompetencë në domenin e sistemit efikas.



KENI PYETJE OSE ANKESA?

Paraqituni në MAPAS ose shkruani mesazh në contact@mapas.mk

Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (MAPAS)
Sllavko Janevski 100, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut:

Tel (02) 3224 229

www.mapas.mk



WWW.MAPAS.MK



FACEBOOK.COM/MAPAS.MK



INSTAGRAM.COM/MAPAS.MK



LINKEDIN.COM/MAPAS.MK